



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Kryesia e Kuvendit

P-005

Prishtinë, më 18 dhjetor 2014, në orën 15:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2014

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljević, Jakup Krasniqi dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari procedoi me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare se është e nevojshme që Kuvendi ta shqyrtojë dhe ta miratojë Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Ai tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa, më 19 dhjetor 2014, do ta shqyrtojë në parim këtë projektligj.

Kryetari propozoi që shqyrtimi dhe miratimi i ligjit të lartpërmendur në Kuvend të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Lidhur me propozimin për shmangie nga Rregullorja për shqyrtimin dhe miratimin në Kuvend të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2015, diskutuan: Visar Ymeri, Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Sasha Milosavljeviq dhe Sabri Hamiti. Diskutimet e plota të tyre janë dhënë në transkript.

Kryesia, në fund, pasi diskutoi lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të hënën, më 22 dhjetor 2014, të mbajë seancën plenare, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryesia lidhur me pikën e lartpërmendur gjithashtu vendosi njëzëri që seancës plenare t'ia paraqesë këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, më procedurë të përshpejtuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, si në vijim:

- 1) Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 bëhet në seancën plenare më 22 dhjetor 2014.
- 2) Komisioni për Buxhet dhe Financa e shqyrton Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime.
- 3) Shqyrtimi i dytë dhe miratimi i Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 bëhet në seancën plenare më 29 dhjetor 2014.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale